



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 640 Prot.

Tiranë, më 01/06/2020

**URDHËR I BRENDSHËM**

Nr. 62, Datë 01/06/2020


**PËR NDËRPRERJEN E PEZULLIMIT DHE RIFILLIMIN E SEANCAVE DËGJIMORE  
DHE MARRJEN E ANKESAVE NË AMBJENTET E INSTITUCIONIT**

Në mbështetje të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Vendimit nr.243 datë 24.03.2020 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, i ndryshuar, Urdhërit nr.156 datë 10.03.2020, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “Për marrjen e masave të vecanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, i ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Rifillimin e të gjitha seancave dëgjimore të pezulluara për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19. Gjatë zhvillimit të seancave lejohet pjesëmarrja e vetëm një përfaqësuesi për secilën palë. Ky rregull vlen edhe në rastet e përfaqësimit ligjor të palëve në proces.
2. Rifillimin e marrjes së ankesave fizikisht në ambjentet e institucionit.
3. Zhvillimin e seancave dëgjimore dhe marrjen e ankesave në përputhje me rregulloren në fuqi gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.
4. Afatet që kishin filluar të llogariten sipas procedurave të parashikuara me ligj, por u pezulluan sipas Urdhërave Nr.42 datë 11.03.2020 dhe Nr.46 datë 24.03.2020, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, do të vazhdojnë të llogariten nga data e hyrjes në fuqi të këtij Urdhëri për pjesën e paplotësuar të afatit.
5. Urdhërat Nr.42 datë 11.03.2020 dhe Nr.46 datë 24.03.2020 shfuqizohen.
6. Ngarkohet Drejtoria e Hetimit Administrativ, Drejtoria e Pritjes së Ankesave si dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse për zbatimin e këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

  
**KOMISIONER**  
*Robert Gajda*  
**Robert GAJDA**